

Procesverbal i përmbledhur i mbledhjes së mbajtur më 25.11.2015

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i përgjithshëm i gjendjës në kolegji
2. Planifikimi i ardhshëm i aktiviteteve të Këshillit të Studentëve
3. Të tjera


Në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit të Studentëve të Kolegjit duke përfshirë edhe anëtarët e rinj të zgjedhur nga gjeneratat.

Në pikën e parë u diskutua gjendja e kolegjit në një pajtim të të gjithëve u shqyrtua mundësia e përgatitjes së një raporti intern nga secili anëtarë i këshillit që të identifikohen të gjitha problemet eventuale si në aspektin akademik ashtu edhe në aspektin organizativ të çështjeve brenda kolegjit. Anëtarët e këshillit dhe përfaqësuesit e gjeneratave nuk ishin të gatshëm të japin një pasqyrë të përgjithshme të problemeve prandaj mbeti që kjo pikë të diskutohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit .


Upropozuan disa aktivitete si mbrëmje shoqërore, aktivitete akademike që përfshijnë klube të leximit dhe diskutimit, klube të debatit dhe aktivitete të tjera që lidhen me aktivitetin e përditshëm në Kolegji. Edhe kjo çështje mbeti të diskutohet në mbledhjen e radhës pasi të jenë mbledhur edhe idetë e studentëve rreth këtyre çështjeve.

Në pikën e tretë të rendit të ditës u propozua riformatimi i funksionit të Këshillit të Studentëve dhe zgjerimi i ndikimit në çështjet brenda kolegjit, pikë kjo që ra poshtë për shkak të rregullores dhe rregullimit të brendshëm dhe të përgjithshëm të funksionimit të Kolegjeve në nivel shteti.

Procesverbalin e mbajti Albion Sutaj – Nënkryetarë i Këshillit të Studentëve të Kolegjit ESLG.



Andi Belegu



Kryetar i Këshillit